

## Njoftim për shtyrjen e thirrjes

Afati për aplikimin në thirrjen Ftesë për ofertë! Projekti “Empowering Municipalities for Transparent CSO Grants”, SHKBSH fton subjektet e interesuara të shprehin interesin për prodhimin dhe printimin e materialeve **shtyhet**.

**Afati i ri i aplikimeve është data 19 Mars 2026.**

**Autoritet kontraktues:** Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë  
Rr. “Ibrahim Rugova”, Kompleksi Green Park, Tiranë

**Data e publikimit: 27 Shkurt 2026**

Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë po zbaton projektin “Empowering Municipalities for Transparent CSO Grants” në kuadër të Programit Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Prendimor 3 (ReLOaD3), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), duke mbështetur bashkitë në zhvillimin e mekanizmave transparente të financimit për OSHC-të, në mënyrë që të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në komunitetin lokal. Në kuadër të këtij projekti, SHKBSH fton subjektet e interesuara të shprehin interesin për prodhimin dhe printimin e materialeve të branduara që përfshijnë: dosje, stilolapsa, blloqe shënimesh, broshura dhe roll-up, me logot e projektit dhe donatorit, për përdorim gjatë trajnimeve, workshop-eve dhe takimeve, me qëllim promovimin e identitetit të projektit. Dizajni i materialeve do të sigurohet nga SHKBSH sipas manualit të brandimit.

### Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sipas kushteve të përgjithshme dhe specifikimeve teknike në tabelën e mëposhtme të kësaj ftese **deri më 19 Mars 2026**, në adresën e e-mailit: [info@shkb.al](mailto:info@shkb.al) ose në adresën postare: **Rr. “Ibrahim Rugova”, Kompleksi Green Park, Kulla 2, Tiranë.**

### Specifikimet Teknike:

Për këtë projekt, SHKBSH do të zhvillojë procedurën e prokurimit për produktet dhe shërbimet, në përputhje me përshkrimet e detajuara në tabelën më poshtë:

Nr	Përshkrimi i mallit/ shërbimit/	Njësi	Sasi	Çmimi/njësi Me TVSH në Lek
1	Dosje me letër 350 gr, e plastifikuar mat, me xhep nga brenda, personalizim full print me logo	Copë	120	

2	Stilolapsa me rezerve ngjyre blu me logo	Copë	120	
3	Blllok me hard cover, përmasë A5 (21x14.5 cm), personalizim full print	Copë	120	
4	Broshurë A4, letër 200 gr, full print (dy faqe)	Cope	120	
5	Roll-up me mekanizëm, përmasë 85x200 cm, full print	Copë	1	

### Specifikime të përgjithshme teknike:

---

- *Materialet duhet të jenë cilësore, të qëndrueshme dhe të printuara me qartësi.*
- *Logoja e projektit dhe e donatorit duhet të jetë e dukshme dhe sipas manualit të brandimit që do të sigurohet nga SHKBSH.*
- *Dorëzimi i materialeve duhet të bëhet brenda datës **03.04.2026**, në adresën: **Rr. "Ibrahim Rugova", Kompleksi Green Park, Kulla 2, Tiranë***

---

### Kushte të përgjithshme:

- 1) Subjektet duhet të jenë të regjistruar dhe licensuar rregullisht me objekt veprimtarie shërbimet e kërkuara;
- 2) Preferohen subjekte të regjistruar me aktivitete në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- 3) Dorëzimi i ofertës do të bëhet vetëm nëpërmjet email në adresën e organizatës [info@shkb.al](mailto:info@shkb.al) brenda datës 19.03.2026 ose në adresën postare Rr. "Ibrahim Rugova", Kompleksi Green Park, Kulla 2, Tiranë. **Nuk pranohen ofertat dorazi.**
- 4) Pagesa e subjektit kryhet me transfertë bankare pas marrjes së shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit. Gjithashtu ofertuesit, krahas Ofertës financiare të plotësuar, e cila duhet të jetë në ALL dhe TVSH të identifikohet në kosto/çmim, duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- 1) Licencën për ushtrimin e aktivitetit ose Ekstraktin e QKB të marre deri një ditë para postimit të ofertës;
- 2) Ofertën financiare për çdo set sipas tabelës më sipër.
- 3) Numrin e llogarisë bankare.

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.

---

